

**KONTRATË SHITJEJE**  
**TË KUOTAVE TË KAPITALIT**

Në Tiranë, sot më datë 14 korrik 2022 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), në selinë e Shoqërisë "FILTO AUDITING" Shpk, të ndodhur në adresën: Sheshi "Ellson", kulla e firmes "Fati", katër 8 të, Tiranë, prej dhe midis palëve të mëposhtme:

**SHITËSI :** Znj. Tatjana Filto, atësia Gaqo, datëlindja 21 Korrik 1957, vendlindja Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në adresën: Rruga "Margarita Tutulani", pallati nr. 6, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 6, Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e dokumentit Leternjoftim me numër 034780750, dhe numër personal F75721022R, me date lëshimi 23/09/2019, autoritet lëshues M.B., që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Pala SHITËSE".

**BLERËSI :** Z. Ares Filto, atësia Dhimitraq datëlindja 18/08/1991, vendlindja Tiranë, shtetas shqiptar, banues në adresën: Rruga "Margarita Tutulani", pallati nr. 6, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 6, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit Leternjoftim me numër 034780759 dhe numër personal J10818047B, me date lëshimi 23/09/2019, autoritet lëshues M.B., që këtu më poshtë do të përcaktohet si "Pala BLERËSE".

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë KONTRATË SHITJEJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT, sipas kushteve dhe kritereve të mëposhtme:

**KUSHTE PARAPRAKE**

Shoqëria "FILTO AUDITING" Sh.p.k., person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 01.02.2008, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, filiali Tiranë dhe e pajisur nga kjo zyrë me Çertifikatë Regjistrimi, Person i Tatueshëm, me numër identifikimi (NUIS) K81401002H, me seli në adresën: Tiranë, Sheshi "Ellson", kulla e firmes "Fati", katër 8 të, Tiranë, Shqipëri, me kapital të shoqërisë në shumën 100.000,00 Lekë (njëqind mijë), me ortake të vetme të shoqërisë Znj. Tatjana Filto, e cila zoteron 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Gjatë veprimtarisë së saj, Shoqëria "FILTO AUDITING" Sh.p.k. drejtobet prej Administratores Tatjana Filto.

Ortaku Zj. Tatjana Filto, kërkon të transferojnë pjesën e kuotes të zotëruara prej saj prej 51% te kapitalit të Shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k., brenda shoqërisë dhe ortakët e shoqërisë dhe janë plotësisht dakord që t'ia shesi ato sipas kushteve dhe kërkesave të parashkruara në këtë kontratë.

Ortakët e shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k., me Vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve të datës 14.07.2022, kanë vendosur lejimin e transferimit të kuotes të zotëruar nga ortaku Zj. Tatjana Filto, nëpërmjet shitjes së 51% (pesëdhjetë e një përqind) te vleres se kapitalit, në kapitalin e Shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k., pjesë këto tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi në favor të ortakëve brenda shoqërisë, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to, për blerjen e së cilave ka shprehur interes Z. Ares Filto.

Meqë ekzistojnë kushte paraprake, të cilat do të janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate, palët, me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin këtë kontratë për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit të shoqërisë (këtë e tutje si "Kontrata"), sipas kushteve të mëposhtme:

#### NENI - 1 - OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, pala Shitëse ortaku Zj. Tatjana Filto, e cili zotëron 100% (njëqind përqind) te vleres se kapitalit te nenshkruar me vlerën prej 100.000,00 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë në kapitalin e shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k., me dëshirën dhe kërkesën e saj i shet dhe i transferon palës blerëse, z. Ares Filto, i cili pranon dhe ble 51% (pesëdhjetë e një përqind) te vleres se kapitalit e barabartë me vlerën prej 51.000,00 (pesëdhjetë e një mijë) lekë në kapitalin e shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k., pjesë tërësisht e lire nga çfarëdolloj detyrimi në favor të të tretëve, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to.

#### NENI - 2 - ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGIMIT

Pjesët prej 51% (pesëdhjetë e një përqind) të vleres se kapitalit, të barabarta me vlerën prej 51.000,00 (pesëdhjetë e një mijë) Lekë, në kapitalin e shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k., të zotëruara prej Shitesit, shiten (transferohen) tek Blerësi, i cili pranon t'i blejë kundrejt çmimit në vlerën totale prej 51.000,00 (pesëdhjetë e një mijë) lekë, si çmim i vetëm përfundimtar dhe i pandryshueshëm.

Shitësi deklaron se Blerësi ka likuiduar totalisht çmimin në shumën prej 51.000,00 (pesëdhjetë e një mijë) lekë,

#### NENI - 3 - KALIMI I PRONËSISË

Që nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe ekzekutimit të detyrimeve të parashikuara nga kjo kontratë, pas transferimit të 51% (pesëdhjetë e një përqind) të pjesëve të kapitalit brenda shoqërisë, raporti i pronësisë në kapitalin e Shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k, do të jetë si më poshtë :

**Ortaku Z. Ares Filto**, do të zotërojë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të Kapitalit me vlerë 51.000,00 lekë (pesëdhjetë e një mijë), të kapitalit të Shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k.

**Ortakja Zj. Tatjana Filto**, do të zotërojë 49% (dyzet e nëntë përqind) të Kapitalit me vlerë 49.000,00 lekë (dyzet e nëntë mijë), të kapitalit të Shoqërisë "FILTO AUDITING" Sh.p.k.

#### NENI - 4 - GARANCITË

Shitësi garanton Blerësin, se kuota objekt kontrate, nuk është objekt pengu dhe janë të lira nga çdo lloj titulli e natyre të të tretëve.

Shitësi garanton Blerësin, për gjendjen kantabile të Shoqërisë "FILTO AUDITING" Shpk., sipas aktit të rakordimit të miratuar ndërmjet tyre dhe për këtë deklaron se do të marrë përsipër të shlyejë personalisht çdo detyrim, borxh dhe /ose pasiv që do të rezultojë për të shkuarën, të tashmen apo në të ardhmen duke e liruar plotësisht blerësat nga detyrimet e rezultuara nga aktiviteti i shoqërisë përparrë datës së nënshkrimit të kontratës.

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme, individualisht për secilin prej blerëse lidhur me të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër kundrejt palës shitëse dhe anansjelltat. Mos respektimi i kushteve të drejtave dhe detyrimeve të prej njërit prej tyre, nuk përbën kusht për zgjidhjen e kësaj kontrate nga pala tjetër, dhe do të vazhdojë të prodhojë efetet juridike të saj, në përputhme me të gjitha të gjitha të drejtat dhe detyrimet për secilin prej tyre.

#### NENI - 5 - BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe Ligji Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Për çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë në lidhje me interpretimin ose ekzekutimin e kësaj kontrate, versioni shqip do të jetë i vetmi version me efekt juridik provues për palët.

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu si dhe për trashëgimtarët e tyre.

#### NENI - 6 - SHPENZIMET DHE TAKSAT

Shpenzimet legale dhe kontabile ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë kontratë, janë në ngarkim të të dyja palëve.

#### NENI - 7 - HARTIMI I KONTRATËS

Kontrata përbëhet nga 3(tre) fletë dhe hartohet në 4(katër) kopje, kopje të barasvlerëshme në gjuhën shqipe. Çdonjëra prej tyre ka përmbytje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë një kopje. Kopja e katërt depozitohet për regjistrim në zyrën e QKB-së.

#### NENI - 8 - HYRJA NË FUQI DHE NËNSHKRIMI I KONTRATËS

Detyrimet dhe të drejtat, që burojnë nga kjo Kontratë, fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënskrimit të kësaj kontrate.

Palët pasi e lexuan me zë tekstin e kësaj kontrate dhe e gjetën përmbytjen e saj, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënskruajnë atë rregullisht sipas legjislativit të Republikës së Shqipërisë.

#### PALËT KONTRAKTORE

##### SHITËSI

Znj. Tatjana Filto



##### BLERËSI

Z. Ares Filto



**VENDIM****I ORTAKËVE TË SHOQËRISË  
FILTO AUDITING SH.P.K**

Sot më datë 15 korrik 2022, u mbajt mbledhja e asamblesë së ortakëve të shoqërisë Filto Auditing sh.p.k me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshmë (NIPT): K81401002H. Mbledhja u mbajt në selinë e Shoqërisë në adresën Sheshi Ëillson Kulla Fati Kat 8, Tiranë me rend dite:

1. Emërimin e Ares Filto si Administrator të shoqërisë Filto Auditing sh.p.k me afat 5 vjecar nga data 15/07/2022 deri më 14/07/2027.

Të pranishëm në mbledhje ishin ortakët e shoqërisë:

1. Ares Filto, datëlindja 18 gusht 1991, vendlindja Tiranë, me numër personal J10818047B zotëruesh i 51% të kuotave të kapitalit.
2. Tatjana Filto, datëlindja 21 korrik 1957, vendlindja Tiranë, me numër personal F75721022R zotëruese e 49% të kuotave të kapitalit.

Me konfirmimin e kuorumi dhe pas diskutimeve ortakët e shoqërisë vendosën unanimisht:

1. Emërimin e Ares Filto, datëlindja 18/08/1991 me numër personal J10818047B si Administrator të shoqërisë Filto Auditing sh.p.k me afat 5 vjecar nga data 15/07/2022 deri më 14/07/2027. Shoqëria do të drejtohet nga dy administratorët, z. Ares Filto dhe zj Tatjana Filto të cilët nuk kanë kufizime në tagrat e përfaqësimit të shoqërisë.
2. Ngarkohet Ares Filto për regjistrimin në QKB të këtij vendimi.

Ortaku i Shoqërisë

TATJANA FILTO



Ortaku i Shoqërisë

ARES FILTO



**VENDIM****I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË  
FILTO AUDITING SH.P.K**

Sot më datë 14 korrik 2022, u mbajt mbledhja e asamblesë të ortakëut të vetëm të shoqërisë Filto Auditing sh.p.k me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm (NIPT): K81401002H. Mbledhja u mbajt në selinë e Shoqërisë në adresën Sheshi Ellson Kulla Fati Kati 8, Tiranë me rend dite:

1. Miratimin e shitjes së 51% të kuotave të shoqërisë Filto Auditing sh.p.k nga Tatjana Filto te Ares Filto në bazë të kontratës së shitjes së kuotave.

Të pranishëm në mbledhje ishin ortakja e vetme e shoqërisë:

1. Tatjana Filto, datëlindja 21 korrik 1957, vendlindja Tiranë, me numër personal F75721022R zotëruese e 100% të kuotave të kapitalit.

Ortakja e vetme e shoqërisë Filto Auditing sh.p.k vendosi:

1. Miratimin e shitjes së 51% të kuotave të shoqërisë Filto Auditing sh.p.k nga Tatjana Filto te Ares Filto në bazë të kontratës së shitjes së kuotave. Me regjistrimin e kësaj kontrate pronësia e shoqërisë do të ndryshojë si në vijim:
  - a. Ares Filto, lindur më 18 gusht 1991, në Tiranë, me numër personal J10818047B do të bëhet zotërues i 51% të kuotave të kapitalit.
  - b. Tatjana Filto, lindur më 21 korrik 1957, në Tiranë, me numër personal F75721022R do të mbetet zotëruese e 49% të kuotave të kapitalit.
2. Ngarkohet z. Ares Filto për regjistrimin në QKB të këtij vendimi.

TATJANA FILTO

ARES FILTO

